

## **KTHEMANI COPEN E TOKES QE ME PERKET**

Spiro Gjickondi nga Qeparoi,  
New York 2005

Kthemani copen e tokes qe me perket!

Ate copen e tokes qe ishte dhe mbetet e imja,  
Ate, copen e tokes, pas se ciles  
Per qindra, ( Ne mos mijera!) vjet  
Katragjyshet e gjyshet  
Dhe prindet e mi vetull-rene  
E mbajten e u mbajten  
Si munden,  
Me thonj e me dhembe...

Kthemani copen e tokes qe me perket!

E dua.  
Ate, copen e tokes me dy rrenje ullinj,  
Me dy rrenje dardhe, tre fiq e nje ftua.  
Ate copen e tokes gjithë gure e shkëmbinj,  
Ne Mbockez, Kallavarez, Rezebrege, Nenpirg...  
Kudo qe te jete, Atje ku ka qene,  
E dua.  
Edhe pse e di se e vogel, sic ish,  
Barkun e zbrazet s'ma mbush,  
Por mallin e shpirtit tim te zhurritur  
E shuan...

Kthemani copen e tokes qe me perket!

E ne se doni te dini nga ku e gjer ku,  
Me ke kufizohet  
Nga Jugu, Perendimi, Veriu, nga Lindja,  
Mos pyesni deshmitare te reme,  
As mos kerkoni tapi te shkruara rishtas  
( Nga ato qe mbjellin kaos!).  
Ne se vertet doni te dini nga ku e gjer ku,  
Merrni kazmen, germoni, Thelle e me thelle,  
Ne shtresen e pare e te dyten,  
Ne shtresen e peste e te dhjete,  
Deri aty ku dheu behet i kuq,  
Mbrujtur me gjak neper shekuj.  
Merrni kazmen, germoni,  
Deri aty ku ri heshtur e klith  
Ai, guri tragjik i sinorit...

Kthemani copen e tokes qe me perket!

Kam pesedhjete vjet i larguar.  
Pesedhjete vjet rrenje-shkukur.

Pesedhjete vjet rrenje-dale.

Pesedhjete vjet si i verber,  
Kaleroj shaluar ne tym,  
Kaleroj shaluar ne mjegull.

Pesedhjete vjet qe lundroj  
Ne nje det t'egersuar  
Plot me ankth, E me frike ne zemer  
Se ne mos u perplasha di ne shkembinj  
Ne nje breg  
Do perplasem pa tjeteter...

C'bera e c'shkrova  
U haruan qe sot.  
Haresa - Mizore  
Nuk pret dot gjer neser.

Te pakten te mbjell n'ate vend  
Nje ulli, Se e di qe ulliri  
Do te jetoje me shekuj.

Kthemani copen e tokes qe me perket!

Sepse dua qe ne perendimin e afert  
Te shkoj e te ulem aty nen ulli  
Te pi nje cigare menduar...

Te vdekurit e gjalle te kujtoj,  
Te haroj te gjallet e vdekur.

Te them: "Ketu dhe im ate ulej e rij..."

Te ndjej eren e thrumbes, Te kruzes, te cfakes...  
Te shkermaq ne pellembe nje dege rigoni,  
Te kepus nje gjethe lofate,  
Ne sy te pikoj Nje pike limoni.

Te ve kembet ne te, si Anteu,  
Te mar force. E ne mbremje,  
Me syte drejt qiellit  
Me henen e yjet te luaj,  
I dehur prej afshit te ngrohete te dheut...

Kthemani copen e tokes qe me perket!

Nuk dua te besoj ne rrenimin e plote.  
Nuk mund ta pranoj nje ikje per jete.  
Rrokullisja pa fund Me rendon.  
Tmerohem e dridhem,

E klith e rrenkoj  
Sa here sjell neper mend Seremben e shkrete:  
"Arberi qe pertej detit na kujton..."

Nuk dua te besoj  
( Sic po thone! )  
Se n'ate vend  
Vec nje parim i zi paska mbetur:  
"Rrembeni, o MUTËR,  
Sa te mundni, me shume, rrembeni,  
Se gjithë ligjet e parimet e tjera  
Kane vdekur..."

Kthemani copen e tokes qe me perket!

Ndryshe do te mbetem i huaj.  
I HUAJ... I HUAJ... I HUAJ...

Me i huaj im bir,  
Im nip me i huaj.  
Ne nje skaj te globit,  
Pa te njohur e te dashurit prane,  
Ne jete te jetes te humbur  
Ne nje skaj te larget te globit,  
As varosur, as gjalle,  
Haruar...

Kthemani copen e tokes qe me perket!

Qe kur casti fundit te vije,  
Kur syte te mbyll  
E te nisem ne udhen ku shkuan te paret,  
N'ate vend te mbulohem,  
N'ate vend te ri shtrire,  
Me nje gur nga te ledhit  
Mbi krye...

E ne se im bir do harroje gjithcka,  
Ne se humbet dashurine per gure e per njerez,  
( Pasi e di se largesa ben punen e saj...)  
Le te jete ai varr, per kthimin e tij, nje arsye me teper...

Kthemani copen e tokes qe me perket...!